Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
Pranuar - Primljeno 25-10-2011
Nj. organit / Org. broj | Numri/Broj | Shtojcë / Prilog | Vlera / Vrednost
01-013/1886

Kuvendi i Komunës së Vitisë
Skupstina opstina Vitina
Municipal Assambly Vitina

Në bazë të nenit 40 paragrafi 2 pika b të Ligjit për vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Gazeta zyrtare nr 28/2008, dhe nenit 35 paragrafi 2 pika b të Statutit të Komunës së Vitisë 013/491 të datës 21.04.2011 Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 21.10.2011 aprovon këtë:

# VENDIM

## PËR APROVIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIN E MJETEVE NGA KATEGORIA EKONOMIKE PAGA DHE MËDITJE NË KATEGORINË EKONOMIKE SHPENZIME KAPITALE NË PROJEKTIN E RI „ ASFALTIMI I RRUGËS SË LAGJËS HALABAKU- POZHORAN„ DHE TRANSFERIN E MJETEVE NË KATEGORIN EKONOMIKE SUBVENCIONE DHE TRANSFERE

Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë APROVON kërkesën e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim për transferin e mjeteve nga kategoria ekonomike Paga dhe Mëditje në kategorinë ekonomike Shpenzime Kapitale në projektin e ri „ Asfaltimi i rrugës së lagjes Halabaku – Pozheran„ dhe transferin e subvencioneve nga Drajtoria e Bujqësisë në Drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere - Fondi burimor 21 në programet e paraqitura në kërkesë.

Neni 2

Pas lejimit të transferit të mjeteve nga neni 1 i këtij vendimi nga Ministria për Financa, Drejtoria Komunale për Financa Ekonomi dhe Zhvillim do të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi pas lejimit të transferit të mjeteve nga Ministria për Financa, miratimit nga Kuvendi dhe nënshrimit nga ana e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Vitisë.

01.Nr.________
Viti, 21.10.2011

KUVESUESI I KOMUNËS
Skenderbe Hebibi

REPUBLIKA E KOSOVËS · REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË · OPŠTINA VITINA
KUVENDI KOMUNËS · SKUPŠTINA OPŠTINE
1